

## RINDËRTIMI I BANESAVE NË FLOQ TË KORÇËS

Në fshatin Floq të Korçës ka përfunduar ndërtimi i banesave të para, të cilat u dëmtuan nga tërmeti, ndërkohë që po punohet intensivisht me qëllim që asnjë familje të mos mbetet pa banesa të paprshatshme në fillim të dimrit. Janë 20 shtëpi që po i nënshtrohen rindërtimit në Floq, ndërsa në total në fshatrat e dëmtuar janë 120 shtëpi, nga të cilat 40 do ndërtohen nga themelet. Këto banesa po ndërtohen nga kompanitë, të cilat kanë kontrata me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë. Pas Floqit do të nisnin punimet për të gjitha shtëpitë e dëmtuara në Qafzëzë, në zonën e Ersekës.

## KONTROLL TREGUT TË HIDROKARBUR- REVE

Strukturat e Inspektoratit Shtetëror Teknik dhe Industrial, në kuadër të aksionit anitinformalitet, kanë vijuar me kontrollin e subjekteve që nxjerrin, përpunojnë dhe tregtojnë hidrokarbure. Në fokus të këtij aksioni janë edhe kushtet e sigurisë në të cilat tregtohen këto produkte. Përgjatë aksit Lezhë-Milot, strukturat e ISHTI-t bllokuan aktivitetin e një pike karburanti pasi nuk përmbushte kushtet e sigurisë teknike të tregtimit.

## TASK FORCA E TRANSPORTIT RRUGOR

Vijojnë monitorimet dhe kontrollet e përditshme në akset kombëtare nga ana e grupeve të Task Forcës së Transportit Rrugor. Si rezultat i shkeljeve të konstatuara janë marrë një sërë masash administrative. 43 masa administrative janë marrë për mjetet që kalojnë kufirin e ngarkesës, ndërsa 50 masa të tjera janë marrë për taksitë pa licencë.

## HEC-KOMAN, REHABILITIM PORTAVE TË SHKARKIMIT

Pas përfundimit me sukses të rehabilitimit elektromekanik të turbinave dhe digës në HEC-Koman, po vijon puna për rehabilitimin e portave të shkarkimit dhe mirëmbajtjes, proces ky që kryhet për herë të parë që nga koha e ndërtimit të hidrocentralit. Ky projekt financohet nga Banka Botërore dhe ecuria e tij është vlerësuar maksimalisht dhe në raportin e fundit të saj.

## AUTOSTRADA TIRANË-DURRËS

Grupet e punës së ARRSH po vijojnë pastrimin e kanaleve të drenazhimit, pastrimin e vegjetacionit dhe largimin e papastërtive në autostradën Tiranë-Durrës përgjatë segmentit mbikalimi Kamëz-Qafë Kashar. Përmes kësaj ndërhyrjeje bëhet e mundur shmangia e problematikave që dëmtojnë rrugën dhe si dhe rritja e sigurisë gjatë motit me reshje.

## MIRËMBAJTJA E LINJAVE TË TRANSMETIMIT

Operatori i Sistemit të Transmetimit vijon investimet me qëllim mirëmbajtjen e linjave të transmetimit duke rritur në këtë mënyrë sigurinë e tyre. Sektori i mirëmbajtjes së linjave të NjOE, ka vijuar me punimet për zëvendësimin e izolatorëve të dëmtuar në shtyllën 119 të linjës 400-1/1 Elbasan2-Zëmplak.